

Observatori për të drejtat e Fëmijëve
Qarku Fier

Qarku Fier përbëhet nga 3 rrethe: Fier, Lushnje dhe Mallkasatër. Në përbërjen administrative të tij përfshihen 6 bashki dhe 36 komuna.

Rrethi Fier përbëhet nga 3 bashki (Bashkia Fier, Roskovec dhe Patos) dhe 14 Komuna.

Rrethi Lushnjë përbëhet nga 2 bashki (Lushnje, Divjakë) dhe 14 komuna.

Rrethi Mallakastër përbëhet nga 1 bashki (Bashkia Ballsh) dhe 8 komuna.

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme, Mars 2011
Burimi: Shërbimi Social Shtetëror, Tiranë (Qershor 2011)



Për rëndësinë ekonomike dhe kulturore dhe për hapësirën e madhe të shtrirjes së tij, Ciceroni e ka quajtur Fierin "qytet të madh dhe hijerëndë".

Regjistrimi i parë i popullsisë është ai i vitit 1923 ku Fieri ishte nënprefekturë nën varësinë e Beratit. Në përbërjen e Fierit përfshiheshin 2 krahina: rrethi Fier me 71 fshatra, 2193 shtëpi dhe 12.760 banorë, krahina e Semanit me 22 fshatra, 305 shtëpi dhe 1940 banorë. Vetë qyteti i Fierit kishte 5 lagje dhe 1493 banorë.

Gjatë fillimit të shekullit të XX-të deri në vitet e Luftës së Dytë Botërore në Fier ndodhën mjaft ndryshime demografike, të cilat u intensifikuan më shumë gjatë viteve '90. Një pjesë e madhe e banorëve kanë emigruar drejt shteteve të huaja dhe kryeqytetit si dhe kanë ardhur banorë nga rrethet e Mallakastrës, Tepelenës, Beratit, Elbasanit, Gjirokastrës si dhe nga zonat veriore e verilindore të Shqipërisë.

Më shumë informacion rreth qarkut mund të gjeni në faqen: http://www.qarkufier.gov.al





Përshkrim mbi situatën e të drejtave të fëmijëve në Qark:

Qarku i Fierit në vitin 2010, ka 487.621[1] banorë dhe 137.511[2] familje në total. Nga numri total i familjeve në qark, 2.889 *familje (2.1%)* janë familje të varfra dhe kanë fëmijë (grupmosha 0-15 vjeç). Fëmijët (0-18 vjeç) përbëjnë *27.8 % të popullsisë (135,330 fëmijë)*.

Në vitin 2010 në Qarku e Fierit *1 në 20 fëmijë* (3632 fëmijë) të grupmoshës 6-15 vjeç jeton në familje e cila trajtohet me Ndihmë Ekonomike (NE).

Përqindja e familjeve që mbështeten me ndihmë ekonomike që kanë fëmijë të moshës 0-18 vjeç në Qarkun e Fierit *paraqitet*

1 Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme, Mars 2011
2 Burimi: Shërbimi Social Shtetëror, Tiranë (Prill 2011)

e lartë në Komunat: Ngraçan Mallakastër (22.84%), Selitë Mallakastër (20.93%), Ruzhdie Fier (12.05%), Qendër Mallakastër (10.79%), - krahasuar kjo me Komunat e tjera të Qarkut. Ndërsa Komunat, të cilat kanë përqindjen më të ulët të familjeve që mbështeten me ndihmë ekonomike me fëmijë të moshës 0-18 vjeç në qarkun e Fierit janë: Levan Fier (0.02%), Tërbuf Lushnje (0.04%), Cakran Fier (0.10%), Libofshë Fier (0.23%).

Nga Observatori është konstatuar se janë 6 Komuna, të cilat nuk janë pjesë e skemës së ndihmës ekonomike ndonëse në këto komuna mund të ketë familje të varfra që kanë nevojë për ndihmë. Konkretisht janë 2 Komuna në rrethin Fier (Topojë dhe Mbrostar), si edhe 4 Komuna në rrethin Lushnje (Grabian, Fiershegan, Bubullimë dhe Allkaj).





Në Qarkun e Fierit, për vitin 2010 janë *2442* fëmijë të moshës 0-18 vjeç me aftësi të kufizuar (PAK)[3], ose *1.8%* të fëmijëve. Numrin më të lartë të fëmijëve me aftësi të kufizuar e ka Bashkia Patos me 212 PAK dhe Komuna Levan me 120 PAK për vitin 2010.

Observatori për të drejtat e fëmijës është një strukturë vëzhguese e shoqërisë civile e ngritur ne qarkun e Fierit në vitin 2011, e cila në bashkëpunim të ngushtë me të gjithë aktorët vendorë publikë e jo-publikë bën mbledhjen sistematike të të dhënave dhe përgatit raporte dhe informacione periodike për aktorët lokalë dhe kombëtarë lidhur me situatën e fëmijëve, shkeljen e të drejtave, zbatimin e legjislacionit në fuqi dhe nevojat për përmirësimin e tij të mëtejshëm.

3 Burimi: Shërbimi Social Shtetëror, Tiranë (Prill 2011)

Observatori për të drejtat e Fëmijëve, Qarku Fier gjendet në:
Lagja Kastriot, Rr. "Brigada e XI sulmuese",
Bashkia Fier,
Fier, Shqipëri
e-mail: observatori_fr@yahoo.com
URL: www.observator.org.al





Politika Rajonale në ndikojnë në realizimin e të drejtave të fëmijëve

Qarku i Fierit vepron aktualisht me Strategjinë kombëtare për të drejtat e fëmijëve pasi nuk ka një Strategji Rajonale.

Në dobi të realizimit dhe përmbushjes të të drejtave të fëmijëve, në Qarkun Fier, veç zyrës së Observatorit, është ngritur dhe funksionon Njësia për të Drejtat e Fëmijëve" në Qark.





Shënim: Të dhënat "Përqindja e fëmijëve që jetojnë pa ujë të përmirësuar të pijshëm, energji elektrike, që jetojnë në banesa të papërshtatshme dhe përqindja e fëmijëve me 1 ose 2 prindër të pa punë",- janë marrë nga studimi i thelluar me autorë A. Ceni dhe V. Kolpeja.